

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më /11/2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: **BOE: “NGSTRUCTURES” shpk me Nr. Nipti L793265020 & “GPG COMPANY” shpk me Nr. Nipti J64324443V.**

Shoqëria: **“NGSTRUCTURES” shpk me seli në Gjirokastrë Tepelenë, pajisur me Nipt me Nr. L793265020 i përfaqësuar nga z. Hekuran Hoxha.**

Shoqëria: **“GPG COMPANY” shpk me seli në Lushnje, pajisur me Nipt me Nr. J64324443V i përfaqësuar nga z. Paqesor Buzi.**

Procedura e prokurimit: Procedurë e HAPUR – MALLRA

Numri i referencës së procedurës: REF-72600-09-22-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit të Korçës 110/35/10 kV”, me fondin total 129, 965,426 (njëqind e njëzet e nëntë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH vënë në dispozicion nga të ardhurat e OSHEE sh.a”, zëri i investimeve 2020 dhe me afat realizimi 6 (gjashtë) muaj, nga nënshkrimi i kontratës.**

Publikime të mëparshme (*Nuk ka*)

Buletini i Njoftimeve Publike *Data 23.09.2020*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë dy Bashkim Operatorësh me vlera përkatëse të ofruar si më poshtë, dhe një OE pa ofertë:

Emërtimi i Shoqërive pjesëmarrëse:

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

NR	Emërtimi i Shoqerive	Oferta në lekë pa TVSH
1	BOE: “ED KONSTRUKSION” shpk me Nr. Nipti K61625001I & “VASSA” shpk me Nr. Nipti J62903470T.	127.041 600
2	“EN – EL” shpk me Nr Nipti L22405011A.	PA OFERTE
3	BOE: “NGSTRUCTURES” shpk me Nr. L79326502O&“GPG COMPANY” shpk me Nr. Nipti J64324443V.	128.189 880

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

BOE: “ED KONSTRUKSION” shpk me Nr. Nipti K61625001I & “VASSA” shpk me Nr. Nipti J62903470T, gjate shqyrtimit te dokumentacionit, komisioni i vlersimit te ofertave konstatoi mungesen e dokumentacionit si më poshtë vijon:

Vlera totale e ofertës pa tvsh = 127 041 600 lekë dhe Vlera totale e ofertës me tvsh = 152 449 920 me tvsh.

Në pikën 1.d. të Kriterëve Të përgjithshme Për Kualifikim, AK ka kërkuar që Ofertuesi duhet të deklarojë se:ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

OE “VASSa” Shpk ka deklaruar shlyerjen e ketyre detyrimeve sipas legjislacionit ne fuqi, ndërkohe, nuk ka permbushur detyrimin e ketij legjislacioni sa I takon detyrimeve te stafit teknik si vijon:

- Z. Aleksander Vasili, drejtues teknik referuar kontrates se punes Nr. 684 Rep., Nr. 190 Kol., date 20.10.2020, paga e tij eshte 50.000 leke, nderkohe, ne listpagesat e muajve Mars, Prill, Maj, Qershor 2020 figuron me page 30.000 leke.

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE

- Z. Kastriot Rira, elektrikist referuar kontrates se punes date 01.01.2020 paga e tij eshte 30.000 leke, nderkohe, ne listpagesat e muajve Mars, Prill, Maj, Qershor, Korrik Gusht 2020 figuron me page 10.000 leke.

Gjithashtu, OE: "Ed Konstruksion" Shpk ka deklaruar shlyerjen e ketyre detyrimeve sipas legjislacionit ne fuqi, nderkohe, nuk ka permbushur detyrimin e ketij legjislacioni sa I takon detyrimeve te stafit teknik si vijon:

- Z. Astrit Lulo, elektrikist referuar kontrates se punes, paga e tij eshte 26.000 leke, nderkohe, ne listpagesat e muajve Qershor 2020 figuron me page 11.818 leke dhe ne Korrik: 23.182
- Znj. Luljeta Lejmoni, Inxhiniere mjedisi referuar kontrates se punes paga e saj eshte 60.000 leke, nderkohe, ne listpagesat e Janarit 2020 figuron me page 35.555 leke.

Sa me siper, OE: "Vassa" Shpk dhe OE: "Ed Konstruksion" Shpk kane vepruar ne kundersizim me pikën 2/d të nenit 45 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet se: **"Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës"**.

Ne piken 1.e te kritereve te vecanta eshte kerkuar: "Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë: e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Per te permbushur kete kriter OE "Ed Konstruksion" Shpk ka paraqitur vertetimin e debise Nr. 8810/1 prot., date 14.10.2020, ku thuhet se kjo shoqeri ka shlyer detyrimet e energjise per kontratat me kod (tabela bashkelidhur)..., por bashkelidhur nuk ka asnje tabele. Pra shoqeria "Ed Konstruksion" Shpk nuk ka paraqitur informacion per asnje kontrate energjie.

Ne piken 2.3.1.b te kritereve te vecanta eshte kerkuar paraqitja e certifikatave iso.

a. Operatori Ekonomik ofertues duhet te paraqese Certifikaten e vlefshme, qe verteton se sistemi i kontrollit dhe menaxhimit te cilesise se tij eshte ne perputhje me ISO 9001 dhe objekti i saj te perputhet me mallrat e kerkuara. Ne rast bashkimi operatoresh secili anetar i bashkimit te operatoreve duhet te zoteroje certifikaten ISO ne perputhje me mallrat qe mer persiper te furnizoje.

(Certifikata duhet të jetë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë).

b) Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën e menaxhimit të sigurisë në punë në lidhje me objektin që prokurohet **ISO 14001** (Përditësuar).

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë certificate **OHSAS -18001-2015** për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (Përditësuar) AK do pranojë edhe certifikatën ISO 45001-2018 **VO**: nëse certifikata është në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet me përkthimin e gjuhës shqipe të noterizuar”.

OE: “VASSa” Shpk nuk ka paraqitur çertifikate **OHSAS -18001-2015 apo ISO 45001-2018** “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, nderkohe që **ka 10 punonjës** dhe duhet domosdoshmërisht të disponojë këto certifikate, që ka lidhje me shëndetin dhe sigurinë e tyre.

Në kriteret të vecanta (kapaciteti teknik) është kërkuar: Për Listën e mëposhtme të artikujve:

- Transformatori fuqisë 110/35/10 kV
- Cele hyrjeje nënstationi 35 kV e integruar me mbrojtje
- Cele fideri nënstationi 35 kV e integruar me mbrojtje
- Kabell TM 35 KV XLPE
- Kabell kontrolli dhe sinjalizimi
- Terminale 35 KV

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

5. Autorizim të prodhuesit/ve për listën e mesipërme të mallrave. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

6. Katalogun/et e prodhuesit/ve në gjuhën angleze për listën e mesipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shenim (Në rastet kur vlerësohen pamundësi të përkthimit të plotë të katalogut nga OE, AK mund të pranojë që OE të paraqesin të përkthyer në gjuhën shqipe vetëm pjesë të rëndësishme teknike të katalogut, ku janë përcaktuar të dhënat teknike/specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi).

Te gjithë kataloget e paraqitura nga BOE “Vassa” SHPK & “Ed Konstruksion” SHPK janë **pa përkthime** në gjuhën shqipe, në kundërshtim me nenin 14/2 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku parashikohet: “Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”.

7. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera, të leshuara nga institucionet e autorizuar ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mëposhtme e materialeve) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.

Test raportet kërkohen për pajisjet e mëposhtme nga fabrika prodhuese:

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

1. Transformatori fuqise 110/35/10 kV
2. Cele hyrjeje nenstacioni 35 kV e integruar me mbrojtje
3. Cele fideri nenstacioni 35 kV e integruar me mbrojtje
4. Kabllot 20 kV XLPE
5. Terminale 20 KV

Teste e tjera do të kryhen në objekt pas instalimit të pajisjeve të listuar më sipër sipas kërkesave “të specifikuar në relacionin teknik” të përshkrimit të punimeve në këtë objekt.

Te gjithë Test raportet e paraqitur nga BOE “Vassa” SHPK & “Ed Konstruksion” SHPK jane pa perkthime ne gjuhen shqipe, ne kundershtrim me nenin 14/2 te VKM Nr. 914 ,datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku parashikohet: “Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”.

8. Çertificate nga prodhuesi i kabllave me protokollet per testat elektrike te qendrushmerise 2 vjecare.

BOE: “Vassa” SHPK & “Ed Konstruksion” SHPK nuk ka paraqitur kete certifikate.

9. Çertificate e standartit IEC 60502-2 e prodhuesit te kabllave ose (ekuivalent).

Çertificata e standartit IEC 60502-2 e paraqitur nga BOE “Vassa” SHPK & “Ed Konstruksion” SHPK, e leshuar nga TSE per prodhuesin “Vatan Kablo” **ka skaduar ne date 08.07.2020**. Per me teper, ky BOE ka paraqitur dokument te rreme per arsye kualifikimi, pasi ne perkthimin ne gjuhen shqipe te kesaj certifikate **eshte hequr rreshti qe pasqyron daten e skadences se saj**.

10. Çertificate nga prodhuesi qe terminalet e ofruar jane ne perputhje me standartin e harmonizuar European CENELEC HD 629.1 S1. Ose (ekuivalent).

Certifikata HD 629.1 S1 e paraqitur nga BOE “Vassa” SHPK & “Ed Konstruksion” SHPK eshte pa perkthim ne gjuhen shqipe, ne kundershtrim me nenin 14/2 te VKM Nr. 914 ,datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku parashikohet: “Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”.

11. Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese tabelat me te dhenat teknike perkatese te materialeve te ofruara.

12. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese deshmi te testimeve (type test) zyrtare te kryera, te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi.

Te gjithë Test raportet e paraqitur nga BOE “Vassa” SHPK & “Ed Konstruksion” SHPK jane pa perkthime ne gjuhen shqipe, ne kundershtrim me nenin 14/2 te VKM Nr. 914 ,datë 29.12.2014

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku parashikohet: “Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”.

Ne piken 2.3.1.g të kriterëve të vecanta është kërkuar: ”Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf teknik, 2 (dy) inxhinier elektrike, dhe 1 (një) inxhinier mekanik si drejtues teknik në licensën e tij.

Në lidhje me këtë pike OE ofertues duhet të paraqesë:

Diplomat e inxhinierit elektrik dhe inxhinierit mekanik si dhe liste pagesat e printuara në sistemin elektronik të tatimeve për periudhën Qershor 2020 – Gusht 2020.

Për inxhinierat pjesë e stafit të cilet duhet detyrimisht të jenë të pasqyruar në listepagesat e shoqërisë për periudhën e mesipërme, duhet të paraqitet kontratë noteriale pune (me kohe të plote) me afat vlefshmerie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt si edhe diplomë + CV+libreze pune”.

Referuar kontratës së bashkëpunimit Nr. 7460 rep., Nr. 2267/1 Kol, datë 20.10.2020, të gjitha punimet mekanike i ka marrë persiper OE “Vassa” SHPK, nderkohe, qe **ky OE nuk ka drejtues teknik inxhinier mekanik**. Kjo shoqëri ka vetëm një drejtues teknik, inxhinier elektrik dhe për këtë ka probleme me përmbushjen e detyrimeve të legjislativës sa i takon shlyrjes së kontributëve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (referuar kontratës së punës Nr. 684 Rep., Nr. 190 Kol., datë 20.10.2020, paga e tij është 50.000 leke, nderkohe, në listepagesat e muajve Mars, Prill, Maj, Qershor 2020 figuron me pagë 30.000 leke).

Pra OE: “Vassa” SHPK, nuk disponon kapacitetet teknike, për të realizuar punimet/shërbimet apo furnizimet që ka marrë persiper, në kundërshtim me nenin 74/3 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.**

Ne piken 2.3.3 (makineri pajisje) të kriterëve të vecanta është kërkuar: ”Operatorët ekonomik duhet të disponojnë:

- Kamion vinç me peshe ngritëse jo më të vogël se 150 ton (minimalisht një copë) - në pronësi ose me qira, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës : Akt pronësie ose kontratë qeraje, shoqëruar me Leje Qarkullimi, Kontrolli Teknik Periodik, Siguracion, foto.

- Makineri qarkullimi vaj në pronësi ose me qira, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës : Akt pronësie ose kontratë qeraje, shoqëruar me Leje Qarkullimi, Kontrolli Teknik Periodik, Siguracion, foto ose deklarata doganore përkatëse.

DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Per mjetet dhe pajisjet e sipercituar duhet te deklarohet vendndodhja dhe Autoriteti kontraktor gezon te drejten per te kryer verifikime per pajisjet/mjetet/makinerite e sipercituara ne çdo kohe ».

Te dyja mjetet/pajisjet e mesiperme, i ka paraqitur shoqeria “Vassa” SHPK, nderkohe, referuar kontrates se bashkepunimit Nr. 7460 rep., Nr. 2267/1 Kol, date 20.10.2020, te gjitha punimet per F.V e transformatorit e ka marre persiper shoqeria “Ed Konstruksion” SHPK. **Pra shoqeria “Ed Konstruksion” SHPK nuk disponon kapacitetet teknike, per te realizuar punimet/sherbimet apo furnizimet qe ka marre persiper**, ne kundertshtim me nenin 74/3 te te VKM Nr. 914 ,date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.**

Vinci me targe AA969TY qe ka OE “Ed Konstruksion” SHPK eshte me peshe ngritese 60 ton dhe I ka skaduar Kontrolli Teknik Periodik (kolaudimi) ne daten 18.10.2020.

Gjithashtu edhe vinci me targe AA545JN qe ka ky OE I ka skaduar Kontrolli Teknik Periodik (kolaudimi) ne daten 18.10.2020, por per kete vinc eshte paraqitur vetem gjysma e lejes se qarkullimit dhe ne gjysmen e paraqitur nuk pasqyrohen te dhenat baze te mjetit: targa, disponuesi, etj.... Dhe ne kete menyre nuk vertetohet nese “gjysma e paraqitur” I perket ketij mjeti

Në nenin 53/3 të të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.

Në nenin 66, pika 3, të VKM Nr. 914 ,date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Sa më sipër, BOE: **“Vassa” Shpk & “Ed Konstruksion” Shpk** skualifikohet për mospërmbushje të kriterëve te kualifikimit.

Pra sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i ofertës së **BOE: “ED KONSTRUKSION” shpk me Nr. NiptiK61625001I & “VASSA” shpk** me Nr. **Nipti J62903470T** në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914,

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Komisioni procedoi me tej me shqyrtimin e dokumentacionit ligjor, ekonomik dhe teknik: Operatori ekonomik: “En - El” shpk Vlera totale e ofertes pa tvsh = 0 lekë dhe Vlera totale e ofertës me tvsh = 0 lekë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga kjo shoqëri, nga ku rezultoi si më poshtë:

Nga verifikimi i dokumentacionit te operatorit ekonomik: “En El” shpk konstatohet se ne sistemin elektronik nuk ka paraqitur oferten ekonomike si dhe asnje dokument ligjor dhe teknik, per kete KVO e konsideron të pamundur vlerësimin dhe klasifikimin e kesaj oferte. Komisioni i Vlerësimit vendosi të s’kualifikojë për arsyet e sipërcituara shoqërinë si më poshtë vijon: “EN EL” shpk.

Sa me siper komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “En-El” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion ne perputhje me kriteret e vendosura ne dokumentat e tenderit dhe vendos ta shpallë të pavlefshme këtë ofertë.

BOE: “NGSTRUCTURES” shpk me Nr. L793265020 & “GPG COMPANY” shpk me Nr. Nipti J64324443V klasifikohet në vend të parë..

Vlera totale e ofertes pa tvsh = 128 189 880 lekë dhe Vlera totale e ofertës me tvsh = 153 827 856 lekë. Afati i realizimit të kontratës është **6 (gjashtë) muaj, nga nenshkrimi i kontrates.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të pikes 4 të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Neni 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, pas shqyrtimit dhe vlerësimit te ofertës së paraqitur nga ky Bashkim Operatoresh, konkludon se oferta në tërësi përmbush kriteret për kualifikim të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit.

Në nenin 53/3 të të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **BOE: “NGSTRUCTURES” shpk me Nr. L793265020 & “GPG COMPANY” shpk me Nr. Nipti J64324443V klasifikohet në vend të parë** se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 128,189,880 (Njëqind e njëzet e tetë milion e njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tetëdhjetë lekë) lekë pa TVSH.

Pikët totale të marra [100] jështë identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë:

Drejtoria e Përgjithshme e Tensionit te Lartë,

Adresa Rr.”Gramoz Pashko”, Vila Gri,Tiranë,Shqipëri,

Tel/Fax Nr. Tel. 00355692317299

E-mail aleksander.pjetri@oshee.al sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 58 të ligjit nr.9643, date 20.11.2007 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 27.10.2020

Ankesa: ka ose jo: Ska